



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data 16.07.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kamionë  
pune 42415200-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:1,800,000 (Një milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Libohovë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c.Formular i ofertës sipas shtojcës 1;*

*d. Lista e çmimeve të artikujve sipas shtojcës 2;*

*e. sipas formularit të specifikimeve teknike shtojca 5;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

### **-Sipas kritereve të përgjithshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit .....  
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3( tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) Lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Si provë për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vertetim xhiro të leshuar nga organet tatimore për vitet 2021, 2022, 2023. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancin e viteve të fundit (2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në dy bilancet e njëpasnjëshem nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor,

organizimin e profesionit te ekspertit kontabel të regjistruar dhe te kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Ofertuesi duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20 % të fondit limit, të realizuara gjate 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Kontrata të realizuara me autoritete kontaktore të cilat detyrimisht duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të asaj kontrate, lëshuar nga autoriteti kontraktor (ku te shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat). Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore të shitjes, (ku te shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat).

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë të shoqëruar me librezën përkatëse dhe me foto të mjetit, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallin e ofruar, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike jo më pak se 1 (një) vit nga marrja në dorezim e mallit objekt prokurimi.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues për mallin objekt prokurimi, duhet të paraqesë një përshkrim të karakteristikave teknike, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

SPECIFIKIME TEKNIKE TË MJETIT, sipas Inxhinierit Mekanik :

**Viti i prodhimit :** jo më parë se viti 2009.

**Kilometra të përshkruara:** jo më shumë se 300,000 km.

**Kabina nr. Vendeve:** Të jetë dopio 6+1 (Gjashtë plus një).

**Dyer:** 4.

**Aksi i pasëm i gomave:** Dopio gomë (6 goma total).

**Karroceria :** Me vetëshkarkim në tre drejtime.

**Kapaciteti mbajtës :** Jo më pak se 1000kg.

**Përmasat/dimensionet e karrocerisë :** Gjatësia 3-3.6 metra. Gjerësia 1.9-2.2metra.

**Motori Cilindrata:** 2200-2500 cm<sup>3</sup>.

**Fuqia motorike:** 125-170 hp.

**Karburanti:** Diesel (nafte). Minimumi Euro 4.

**Lloji i Kutisë së shpejtësisë:** Manual minimalisht 5 marsha.

**Numri i akseve:** 2(dy)

**Sistem:** ABS, EPS, Bllokim diferenciali, etj.

Ajër të kondicionuar

Airbag .

Dokumentacionin e plotë në emër të AK, si vijon :

- Çertifikatën e pronësisë së mjetit ose certifikat e regjistrimit në original në emër të ofertuesit.
- Lejen e qarkullimit të mjetit.
- Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike TPL.

[Nese materiali/et te cilat do te paraqiten per te permbushur kriterin e mesiperperm jane ne gjuhe te huaj, ato duhet te perkthehen ne shqip per pjesen e te dhenave teknike te kerkuara si dhe te noterizuara].

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020

**“Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet: ”Autoriteti/entë kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

**Niko Këreci**

**Kostandino Çela**

**Arjola Dhjamandi**